



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Seancë plenare

P-089

Prishtinë, më 30 dhjetor 2016, ora 21:00

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 30 DHJETOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të caktuar me vendimet të Kuvendit, datë 30. 12. 2016.

Ai procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare, mbështetur në vendimin e Kuvendit, nr. 05-V-407, datë 30 dhjetor 2016, e kanë shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-141 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL që ta paraqesë raportin e këtij komisioni.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, z. Nehat Baftiu e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime të këtij komisioni.

Në këtë projektligj ishin paraqitur 7 amendamente.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara një nga një.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 3, 4A, 5A dhe 6.

Kuvendi nuk i miratoi këto amendamente: 1, 2, 4B, 5, B dhe 5C, 7 dhe 8.

Në fund, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	44
Kundër -----	8
Abstenime -----	11.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-141 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryetari i mbylli punimet e kësaj seance dhe të Sesionit vjeshtor në orën 22:00.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*